



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Nr. 02/ 5.1.1

Datë: 14.11.2022

PROCESVERBAL

i mbledhjes së -VII- (shtatë) të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa

RENDI I DITËS

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi dhe miratimi Raportit nr.04/965 datë:14.10.2022 i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Shtator 2022.
3. Shqyrtimi i Raportit të performancës për vitin 2021.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Komisionit Komunal të Aksionarëve për ndërmarrjen publike “EKO-Regjioni” SH.A Prizren, njësia në Malishevë
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Komitetit për Shëndetësi, mirëqenie sociale dhe persona me aftësi të veqanta për vitin 2022.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/1742 datë:11.10.2022 e parashtruar nga Bashkësia Islame në Malishevë, për vazhdimin dhe plotësimin e kontratës për shërbime të varrimit.
7. Shqyrtimi i kërkesave.
8. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 02.11.2022 dhe filloi në ora: 10:30. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi, Muharrem Morina, Drejtori për Buxhet dhe Financa Blerim Thaçi, antarët e komisionit: Rukije Bytyqi, Gentianë Hoti, Arlindë Rudi, Veton Zogaj, Hamit Lima, Sadik Vrenezi, përfaqësues nga OSBE-ja dhe zyra për informim.

Argjend Thaçi: Përsëritje për të gjithë dhe mirë se keni ardhur në mbledhjen e shtatë të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa!

Në këtë mbledhje kemi 8 pika të rendit të ditës. Kemi dhe dy propozime që të futen në rend të ditës: Plani i punës për Bujqësi dhe Plani për Barazi Gjinore. Kërkoj dhe pika e 4 e rendit të ditës Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Komisionit Komunal të Aksionarëve për ndërmarrjen publike “EKO-Regjioni” SH.A Prizren, njësia në Malishevë të largohet nga rendi i ditës, sepse ende nuk na është kthyer konfirmi i ligjshmërisë nga MAP-ja. Kush është për që kjo pikë të largohet nga rendi i ditës?

Me vota unanime, kjo pikë largohet nga rendi i ditës.

Kush është për që Plani i Punës së Komitetit për Barazi Gjinore të futet në rend të ditës?

Me vota unanime, kjo pikë hynë në rend të ditës.

Kush është për që Plani i punës të Komitetit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural të futet në rend të ditës?

Me vota unanime, kjo pikë hynë në rend të ditës.

Hapi debat rreth rendit të ditës. Nëse nuk ka diskutues, kush është për këtë rend të ditës?

Unanimisht, votohet rendi i ditës.

Pika e parë e rendit të ditës është shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. Hapi debat rreth kësaj pike. Nëse nuk ka diskutues, kush është për miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar?

Me vota unanime, aprovohet procesverbali nga mbledhja e kaluar.

Kalojmë në pikën e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi Raportit nr.04/965 datë:14.10.2022 i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Shtator 2022.Urdhëro, Drejtor!

Blerim Thaçi: Përshëndetje për të gjithë!

Do ndalem të çështja e mjeteve të alokuara për këtë periudhë që ka qenë vlere prej 10.445.861.25E, nga alokimet e realizuara të tyre ka qenë 72%, ndërsa si total i shpenzimit në periudhën 9 mujore është përafërsisht 64%, ndërsa pasqyra e fundit që e kemi nxjerrur dje ka kaluar vlerën e shpenzimit 70% dhe tani është periudha e tetorit dhe dhjetorit që është faza më intenzive e shpenzimit të mjeteve. Besoj që relaizimi i buxhetit për vitin 2022 do të jetë në një përqindje të knaqshme.

Në vitin 2022 të hyrat vetanake kanë qenë në vlerë 1,033,469.00E. Për këtë periudhë janë inkasuar 991,158.09E. Tani e kemi tejkaluar vlerën e planifikimit të të hyrave vetanake për vitin 2022.

Faleminderit!

Argjend Thaçi: Faleminderit drejtor për Raportin! Urdhëro, Rukije!

Rukije Bytyqi: Përshëndetje për të gjithë!

Po shihet që është bërë një punë e madhe, diku 96% janë realizuar të gjitha këto të hyra. E përgëzoj drejtorin për këtë punë kaq të madhe në realizimin e këtyre të hyrave.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Muharrem!

Muharrem Morina: Prej cila të hyrave ka tejkalim?

Argjend Thaçi: Urdhëro, Drejtor!

Blerim Thaçi: Tatimi në pronë është që ka inkasu më së shumti, por është dhe një rritje e gjobave në trafik. Do kemi të hyra të tjera që do të realizohen këtë vit, sepse dhe Rregullorja i ka ngritur disa tarifa dhe pritet që nëse hynë projekti për çështjen e mbeturinave dhe do të inkasohen si të hyra.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Faleminderit, Kryesues, përshëndetje për të gjithë!

Ajo çka e vlersoj shumë në këtë aspekt është puna që po bëhet në inkasimin e të hyrave vetaanake. Kjo më gëzon, sepse Komuna e Malishevës deri në vitet e fundit ka pasur një performancë të keqe sa i përket inkasimit të të hyrave vetanake dhe tani po shihet një rritje rekorde e inkasimit.

Te vlerat e sektorëve të inkasimit që realisht duhet të jenë në top pozitën e parë që inkasojnë të hyra . Të hyrat vetanake në mënyrë analitike tabela 5.1 te certifikatat e lindjes është vetëm 200E, ne nga 1E paguajm për certifikata dhe po më duket vlerë e ulët 200E.

Çertifikatat e vdekjes janë 00, pse nuk janë inkasu, apo janë të liruar nga pagesa.

Gjoha nga inspektorati janë 1,798.92E është shifër e ulët, sepse ne kemi shumë shkelje prej qendrave tregtare, prej subjekteve të tjera afariste për shkak se nuk i përfillin procedurat ligjore.

Licencat tjera për afarizëm 180E në vitin 2022, ndërsa në vitin 2021 ka qenë 1,365.20E dhe kjo shifër është e ulët.

Taksa për leje ndërtimi 108,692.77E ka qenë në vitin 2021, ndërsa në vitin 2022 është 93,752.30E.

Pranimi teknik i lokaleve në vitin 2022 është 00, në vitin 2021 është 1,197.00E.

Të hyrat nga Agjensioni i pyjeve është 00, kjo është e papërfillshme sepse ne çdo ditë kemi prerje të pyjeve dhe me të figuru 00 si gjoha, kjo po i bie që ky Agjensioni i pyjeve nuk janë duke kryer kurrfarë pune.

Te shpenzimet për mallra dhe shërbime në mënyrë analitike, te vendimet e gjykatës në vitin 2022 i kemi 13,881.77E, ndërsa në vitin 2021 i kemi pasur 1,572.01E, është një rritje e kësaj shume. A janë vendime të shujtave apo qfarë vendime janë këto.

Ka një dyfishim te drekat zyrtare në vitin 2022 është 13,700.50E, ndërsa në vitin 2021 kanë qenë 7,054.9E është një dyfishim i kësaj.

Karburant për vetura në vitin 2022 është 63,795.05E, ndërsa në vitin 2021 ka qenë 25,924.97E, kjo po i bie më shumë se dyfishim.

Shpenzime për antarsim, çka nënkuptojnë këto shpenzime, 8,500.00E kanë qenë në vitin 2022, ndërsa 3,000.00E në vitin 2021.

Blerim Thaçi: Antarsim në kolegjum, në Asosacion të komunave, janë grumbulluar sepse ka disa vite që nuk janë paguar dhe tani i kemi paguar

Veton Zogaj: Shpenzimet për investimet kapitale në mënyrë analitike te Drejtoria e Urbanizmit ka shumë shifra që janë realizuar punimet . Kanalizime janë 312,549.99E, mirëpo unë në teren nuk kam parë shumë punime për ndërtimin e kanalizimeve. Këto pyetje do ja parashtroj Drejtorit të Urbanizmit.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Drejtor!

Blerim Thaçi: Para jush është një raport i pasqyrave financiare të të hyrave dhe shpenzimeve. Ashtu siç i sjellin dikastieret tjera edhe ekzekutohen dhe do ishte më mirë që disa raporte të kërkohen prej drejtorive përkatëse. Te certifikatat e lindjes është një çështje e Unirefit, ka mundësi që hynë në këtë pikën e 4 te certifikatat e tjera. Për këtë pjesë do marr informacione nga Drejtori i Administratës. Sa i përket Urbanizmit taksat për legalizimin e objekteve, nuk e di a ka pasur legalizime të objekteve këtë vit.

Veton Zogaj: Në mbledhjet e kaluara i kemi pasur dy çerdhet publike që e kanë kryer këtë procedurë aneksi i çerdhes.

Blerim Thaçi: Pranimi teknik i çerdhes në Kijevë është kryer më herët, ndërsa në Malishevë nuk e di a i ka dy jave që është pranuar. Vendimet e gjykatës janë këto qështje që janë ekzekutuar dhe disa pagesa të shujtave të mësimdhënësve. Drekat zyrtare këtu mund të ndikojë dhe rritja e qmimeve, mirëpo dhe ka pasur më shumë shpenzime se në vitin 2021.

Argjend Thaçi: Viti 2021 ka qenë dhe vit pandemik.

Blerim Thaçi: Në vitin 2021, 3 muaj nuk ka pasur mësim, dhe çerdhja është ajo që na krijon shpenzimet mujore, përafërsisht 1200-1500E. Te shpenzimet për dreka hynë dhe disa trajnime, seminare që i ka mbajtur Drejtoria e Arsimit. Ne kemi pasur obligime të vitit të kaluar që I kemi përfunduar këtë vit dhe tash vitit 2021 i zvogëlohen shpenzimet dhe si shpenzime rriten në vitin 2022.

Veton Zogaj: Në kuadër të Drejtorisë së Arsimit, a egziston ndonjë mundësi që ndarja buxhetore me ju ndarë shkollave që ato me menaxhu buxhetin, psh për shpenzimet që i kanë për mirëmbajtje, për paisje të tjera teknologjike. Pra, të kenë një buxhet që e bëjnë një planifikim vjetor e dërgojnë në drejtori dhe pastaj bëhet decentralizimi dhe jo të vjen drejtori për një gjë ta kërkoj në drejtori të arsimit.

Blerim Thaçi: Buxheti në arsim planifikohet në numër të nxënësve dhe decentralizimin kemi kërkuar ta bëjmë, mirëpo është diqka e pamundshme.

Argjend Thaçi: Kush është për që pika shqyrtimi dhe miratimi Raportit nr.04/965 datë:14.10.2022 i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Shtator 2022 të rekomandohet për Kuvend?

Me vota unanime, kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

Kalojmë në pikën shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Komitetit për Shëndetësi, mirëqenie sociale dhe persona me aftësi të veqanta për vitin 2022. Raporti është shumë i shkurtër, pasi që konstatimi është bërë me vonesë. Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: I kam parë aktivitetet dhe objektivat që i kanë vendosur ky Komitet. Unë në dallim prej komiteteve të tjera pres më shumë punë prej këti komiteti dhe 90% e këti Komiteti janë profesionist të fushës së shëndetësisë. Draft plani është kogja specifike dhe vizitat që do I bëjnë në QKMF-ë dhe në QMF në fshatra dhe uroj që ta përmbushin..

Argjend Thaçi: Urdhëro, Gentianë!

Gentianë Hoti: Ka pasur dhe qështje tjera që kanë mundur me e zgjeru më shumë dhe uroj që t'i përmbushin këto aktivitete.

Argjend Thaçi: Kush është për që pika shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Komitetit për Shëndetësi, mirëqenie sociale dhe persona me aftësi të veqanta për vitin 2022 të rekomandohet për Kuvend?

Me vota unanime, kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

Kalojmë në pikën tjetër shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.Urdhëro, Sadik!

Sadik Vrenezi: Periudha është e shkurtër , por ka disa aktivitete që i kemi planifikar.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Unë prej këti Komiteti të Bujqësisë pres që të kenë një fokus të veçantë në ndarjen e subvensioneve që i ndan Drejtoria për Bujqësi. Për dallim nga drejtorit e tjera kjo drejtori e ka një buxhet kogja të madh dhe do ishte mirë me pas një mbikqyrje të subvensioneve, përfituesve.

Argjend Thaçi: Kush është që Plani i punës së Bujqësisë të rekomandohet për Kuvend?

Me vota unanime, kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

Kalojmë në pikën shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës për Barazi Gjinore. Urdhëro, Rukije!

Rukije Bytyqi: Në këtë Plan të punës e pasken bërë një punë kogja të mirë, uroj që të realizohet. Janë planifikuar që të mbahen këto aktivitete për muajin tetor, mirëpo nuk e kam parë që ka qenë shumë mediatike për kancerin e gjirit. Te muaji nëntor dhe dhjetor janë disa aktivitete që do të mbahen, shpresoj që te muaji nëntor të shënimimi i 16 ditëshit për aktivitete për aktivizimin e sensibilizimin kundër dhunës dhe diskriminimit gjinor, kjo të jetë më shumë mediatike për dhunën që po ndodh rreth diskriminimit gjinor, ndërsa takimi i komandantin e policisë po besoj që janë të nevojshme dhe shënimimi për të drejtat e njeriut sepse çdo ditë e më shumë po shkelen të drejtat e njeriut dhe mendoj që duhet ti përmbahen këti plani .

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Si rekomandim kisha shtuar që te listat e vizitave që i ka parapar t'i shtohet dhe takim me Drejtorin për Qendrën për punë sociale, takim me drejtoreshën e strehimores në Gjakovë, sepse komuna e Malishevës ka obligime financiare ndaj këti institucioni. Është mirë të ketë dhe një takim me zyrtarët e gjykatës themelore këtu në Malishevë që të dihet se sa janë rastet e dhunës dhe si trajtohen landët.

Argjend Thaçi: Kush është që pika shqyrtimi dhe miratimi i Planit për Barazi Gjinore të rekomandohet për Kuvend?

Me vota unanime, kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

Drejtori i Administratës është këtu dhe kalojmë në pikën shqyrtimi i Raportit të performancës për vitin 2021. Urdhëro, Drejtor!

Fatmir Ademaj: Përsëndetje për të gjithë!

Ekipi i performancën përbëhet kryesisht nga të gjitha drejtorit dhe udhëheqet nga kordinatori për performancë Arsim Morina. Gjatë vitit 2021 ashtu siç shihet në raport të MAPL-së janë verifikuar të gjitha fushat, përkatësisht përmes 140 treguesëve ku janë specifikuar tabelat e Malishevës në të gjitha fushat. Ka pasur një lëvizje pozitive për vitin 2021. Kemi punuar me të gjitha drejtorit që punët të cilat janë kryer të regjistroheshin, sepse shpeshherë punët janë përfunduar mirëpo nuk janë futur në sistem. Përmes sitemit të cilit i obligohemi t'i deklarojmë ne kemi arritur që ta lëvizimin komunën e Malishevës për disa vende. Ky raport nuk ka mundësi për ndërhyrje, pasi që e bënë Ministria e Pushtetit Lokal ku ne obligohemi ta rrisim performancën që të dërgohet në asamblen komunale.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Nuk e di a keni fituar ndonjëherë grand për performancë si komunë, sepse komunat tjera janë përfituese. Shërbime administrative ne duhet ta kemi fokuesin aty, sepse komuna është njësi administrative, që të bëhet një decentralizim dhe fokues i këtyre shërbimeve.

Transparenca komunale 100% është vlersuar, këtu jemi në rregull nuk kam ndonjë dileme.

Përgjeshmëria komunale 83% kryesisht obligimi i vendimeve, akteve të tjera në ueb faqen e komunës.

Barazia në punësim, shërbimet sociale 68%, këtu ndoshta ka më shumë fokues te arsimit dhe te shëndetësisë që i prek, është shifër e knaqshme dhe pse do ishte më mirë të jetë qind për qind.

Kultura, rina dhe sporti përgëzime për drejtorin dhe për raport po thotë që është 100% e realizueshme. Në

19 fusha radhitet në vendin e 8 dhe kjo pikë është për tu vlersuar.

Menaxhimi i fatkeqësive natyrore qëndrojm jashtzakonisht keq, jemi në venin e 19 si komunë në raport me komunat e tjera.

Planifikimi hapsinor 45%, jemi në vendin e 18 si komunë.

Hapsira publike 51.2%, jemi në vendin e 16 si komunë.

Transporti publik jemi në vendin e 13, të knashëm pasi jemi në pjesën e parë të tabelës.

Uji i pishëm 94.0%, ndërsa Malisheva është kogja keq me ujë të pijes dhe radhitemi si komuna e 8 në raport me komunat e tjera.

Kanalizimi- drejtori i urbanizmit shpesh paraqet si të dhëna që i kemi rregulluar dhe këtu jemi në vendin e 27 .

Fatmir Ademaj: Nuk është ndonjëherë që punët që janë kryer, por punët që janë raportuar. Përformanca paraqet rezultatet e asaj që i kanë bërë drejtorit, por që nuk i kanë futur të dhënat.

Veton Zogaj: Këtu po thotë që transparenca dhe futja e të dhënave në ueb faqe është i knaqshëm, 83.30% që nënkupton që janë futur informacionet.

Fatmir Ademaj: Dhe për uebfaqen është e njëjta kategori me kanalizimet, për shkak se e ka pasur për obligim zyrtari i uebfaqes me i kry aktivitetet për uebfaqe psh për njoftimet për rend dite.

Veton Zogaj: Menaxhimi i mbeturinave jemi në vendin e 23 dhe shihet dhe në teren që jemi keq.

Mbrojtja e mjedisit jemi në vendin e 21.

Përfaqësimi gjinor jemi skajshmërisht keq, duke filluar nga drejtorit këtu në qeverin komunale, drejtorëve të shkollave.

Kujdesi primar shëndetësor, drejtori nuk ka qenë asnjëherë në seancë me na raportu dhe këtu jemi në vendin e 26.

Zhvillimi ekonomik lokal jemi 5.73%, në nivelin më të ulët të mundshëm, në vendin e 33.

Drejtor, kjo përformancë na penalizon neve në përfitimin e grandeve që ndahen për përformancë. Nëse është arsyetimi yt që nuk janë futur të dhënat në bazë të fushave përkatëse atëherë dhe ty si drejtor dhe kryetarit ju bie barra që të ju bëhet presion.

Muharrem Morina: Komuna e Malishevës është përfituese e këtyre grandeve. Ka fusha që janë më mirë se sa që janë paraqitur në raport, por zyrtari që i mbulon atë fushë të caktuar nuk i ka ofruar dokumentet e caktuara.

Rukije Bytyqi: Këtë raport që po e shohë po vërehet që ka shumë mangësi dhe ju kanë ikur dhe shumë punëve të mira që janë bërë në shumë fusha. Te kujdesi shëndetësor, asnjëherë unë nuk kam pasur problem ose një pritje të keqe të puntorëve aty dhe këtu janë vlersuar shumë pak me 34%. Ndoshta është qëllimisht i punar kështu vetëm që ta ulin përformancën e komunës tonë. Te përfaqësimi gjinor ne e dimë që nuk jemi shumë mirë, mirëpo nuk jemi në këtë nivelin që na kanë vlersuar.

Argjend Thaçi: Kalojmë në pikën tjetër shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/1742 datë:11.10.2022 e parashtruar nga Bashkësia Islame në Malishevë, për vazhdimin dhe plotësimin e kontratës për shërbime të varrimit.Kërkojnë që të vazhdojnë marrveshjen për kryerjen e shërbimeve të varrimeve për periudhën 2 vjeqare, poashtu duke pasur parasysh rritjen e qmimeve kërkon nga komuna e Malishevës që marrveshja e

re për shërbime të varrimit të plotësohet dhe të përfshihet rritja e nevojshme si dhe pikat e bashkangjitura në këtë kërkesë. Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: E para me këto logo me mbishkrimin arab më nuk e sjellin në Kuvend sepse nuk kemi nevojë me pas këtë. Unë pajtoj që duhet me u kry këto shërbime, mirëpo mbi bazën e një raporti që e bëjnë ata, pastaj dhe munden me u vlersu qmimet. Ne e dimë që janë ngritur qmimet mirëpo jo në masën në të cilën ata e kanë vlersu, sepse nuk kanë sjellur diqka konkrete. 230E ka qenë dhe këtu po kërkon me u rrit për 40%. Realisht për shumën dhe mundem me u pajtu, mirëpo për angazhimin e dy puntorëve nuk e di.

Argjend Thaçi: Po besoj që këto i ka bërë arsytime te rritja e kostos, nuk po besoj që do të jenë plus këto.

Veton Zogaj: Këtu thotë që përveq kësaj Bashkësia Islame- në Malishevë gjatë realizimit të shpërbimit të varrimit po ngarkohet dhe me këto shpenzime shtesë dhe që përveq qmimit kjo po kërkon dhe angazhimin e dy puntorëve shtesë.

Muharrem Morina: Kërkesë të tillë e ka sjellur dhe te ne. Është mirë që ju grupet parlamentare bashkë me kryetarin me u ulë me ta dhe të bisedohet, ashtu siç kanë bërë grupet parlamentare paraprake me ish kryetarin. Egziston rregullorja komunale për mirmbajtjen e varrezave që e autorizon kryetarin me lidh marrveshje me ta. Kryesuesi bashkë me shefat e grupeve me caktu një takim me kryetarin, me drejtorin e financave dhe me shiku që a ka mundësi me i përkrahë në mënyrë financiare këtë projekt dhe si ka mundësi dhe pastaj me ardhë në kuvend. Pas vendimit të kuvendit kryetari lidh marrveshje me ta dhe në marrveshje specifikohen të gjitha. Para se të lidhet kjo marrveshje në kuvend të vijë raporti i marrveshjes dy vjeqare.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Raportin e mëhershëm dhe unë personalisht kam ngritur padi kundër bashkësisë islame, sepse ka pasur të dhëna ekstreme të pavërteta aty. Gruja e agjes që vetë ja kam blerë arkivolin, aty figuron që e ka marrur arkivolin dhe i kam identifikuar mbi 15 raste që kanë qenë që i kam dërguar dhe ata njerëz me dëshmu. Të jepet shuma sakt qe po kërkojnë. Të ulemi grupet politike dhe secili e thotë qëndrimin e tij dhe Bashkësia Islame le ti sjellin argumentet e tyre se pse duhet të rritet ky qmim.

Hamit Lima: Prej 0-5 vjeç e kanë pa pagesë. Kur ka qenë kërkesa e mëhershme unë kam qenë kundër, sepse kanë kërkuar nga 230E të rritet 290, sepse qe dy vite arkivolet 60% nuk janë financuar sepse janë ardhur nga Prishtina shkaku pandemies. Ku janë ato mjete?

Ato raporte çdo familjar ta ketë një kopje, një kopje Bashkësia Islame dhe një kopje me sjellë në komunë. Unë jam që dhe transportin e kufomave me kry Bashkësia Islame, sepse ka vetura dhe munden me kry.

Argjend Thaçi: Ne po e rekomandojmë për kuvend dhe para mbledhjes së kuvendit ne e bëjmë një takim shefat e grupeve me Bashkësinë Islame. Urdhëro, Rukije!

Rukije Bytyqi: Kjo koha dy vjeqare, nëse ndodh që vitin tjetër me u ulë qmimet qka do ndodh?

Argjend Thaçi: Urdhëro, Gentianë!

Gentianë Hoti: Është mirë që ne ta mbajmë takimin me Bashkësinë Islame, mirëpo asesi mos të vonohet kontrata e këtyre, sepse qytetarët kanë nevojë për këto shërbime. Do ishte mirë që bashkarisht me I hulumtu disa raste dhe me shiqu se çka është duke u bërë.

Argjend Thaçi: Bashkësia Islame është duke bërë dhe donacione nëpër shkolla, është duke hapur puse dhe është duke bërë donacione të ndryshme dhe nëse ato mjete të arkivolit i destinon për qështje të bamirsis nuk besoj që ka diqka të keqe.

Muharrem Morina: Këtë ngjare e kanë hetuar dhe krimet ekonomike dhe në raport kanë dalur jo mirë.

Argjend Thaçi: Kush është që kjo pikë e rendit të ditës të rekomandohet për Kuvend?

Për: 6

Kundër: 1

Abstenim: 0

Te pika të ndryshme a e dëshiron dikush fjalën. Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Kisha kërkuar që të futet në kuvend një raportim nga kryetari i dy projekteve të sheshit dhe rrugës “Ibrahim Mazreku”.

Argjend Thaçi: Kalojmë në pikën shqyrtimi i kërkesave. Kërkesa e Ramiz Islam Kryeziu thotë që meqë ka filluar restaurimi i mullirit të Zenel Islam Kryeziu, ne si pjestar të kësaj familje jemi të interesuar që këto ambiente të bëhen sa më shumë turistike dhe me vlera historike. Vendi ku quhet Mwrizet nr i parceles 825 mund të shëndrrohet si një vend atraktiv dhe jemi të interesuar që në këtë vend të mbillen drunjë dhe të vendosen disa korrike dhe lodra për fëmije. Ka kërkuar përkrahje buxhetore dhe paisje me leje të së drejtës së shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së këtij vendi turistik. Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Ne duhet të dimë ajo a është pronë publike, sepse këtu po e kërkon dhe një zonë rrethit. Këtë duhet të ja kthejm drejtorive përkatëse Gjeodezisë dhe Urbanizimit që ta shohim a është pronë publike ajo pjesë te mullini që po kërkojnë me bërë si park.

Argjend Thaçi: Po i dërgojmë në Urbanizëm, në Kulturë dhe në Gjeodezi.

Hamit Lima: Në kuadër të drejtorive është mirë ta bëjme njëfar parku si shenjë respekti për atë kohë. Në kuadër të kësaj meriton një përkrahje.

Argjend Thaçi: Duhet formulim prej drejtorive.

Muharrem Morina: Ministria e Kulturës e ka listen për mbrojtjen e trashëgimisw së kulturës, materiale, natyrore. Nëse është në listen e mbrojtjes atëherë Ministria e mbron atë, mirëpo nuk do të thotë që komuna nuk ka të drejtë me investu aty.

Argjend Thaçi: Kush është për që kërkesa e Ramiz Islam Kryeziu të rekomandohet të Drejtoria e Kulturës, Urbanizmit dhe Gjeodezisë.

Me vota unanime, kjo pikë rekomandohet për te drejtorit përkatëse.

Kërkesa tjetër është e Shoqatës së të verbërve për pranimin në buxhetin e vitit 2023 shumën 9970E për përkrahje financiare për ofrimin e shërbimeve specifike për persona të verbër në shoqatën komunale e të verbërve në Malishevë.

Muharrem Morina: Mandatin e kaluar asamble ja ka ndarë, mirëpo ky ka menduar që në momentin që asamble ja ndan mjetet drejtoria e financave ja qet mjetet në konto dhe ai I bënë këto projekte. Unë e kam njoftuar këtë Isak Krasniqin që ti nuk mundesh me përfitu në këtë formë ligjërishit . Në momentin që komuna e bënë thirrjen për financimin e OJQ-ve dhe me përfshi dhe si aktivitet në atë thirrje dhe pastaj ti me atë projektin tënd duhet me apliku aty.Të gjitha aktivitet duhet të përcillen me raporte të mbikqyrstit të ati projekti.

Veton Zogaj: Ai duhet me prit thirrjen publike kur ndahen mjete për OJQ.

Muharrem Morina: Ata duhet ti plotësojnë kriteret kur të aplikojnë.Duhet të njoftohen që të përgaditen për thirrje publike.

Argjend Thaçi: Në kuadër të refuzimit të jepet arsyetimi. Kush është për që kjo kërkesë të refuzohet dhe të i jepet një arsyetim?

Unanimisht kjo pikë refuzohet.

Kemi një ankesë nga Luan Bytyqi ndaj vendimit të marrë nga asamble komunale dhe atë vendim e kundërshtojmë fuqishëm kryesia e fshatit dhe fshati në përgjithësi. Vendimi është që e kemi marrur për lejimin e rrethimit të varrezave në fshatin Shkozë.

Hamit Lima: Nëse është i paknaqur, le ta dërgon në MAPL-ë ndonjë ankesë.

Muharrem Morina:Vendimi i asambles është shumë i ligjshëm në aspektin e vendimarrjes. Muri që është vendosur aty nuk duhet të jetë pengesë për komunën, për rrugën dhe për palën e tretë. Pala e tretë është nëse dikush ka prona aty dhe e pengon.

Argjend Thaçi: KPF-ja nuk është për ankesa

Veton Zogaj: Kur vjen ligjshmëria e vendimit nga MAPL-ja, mundet me ju drejtu ankesën MAPL-së për vendimin e kuvendit.

Argjend Thaçi: Kjo ankesë nuk është objekt i trajtimit të KPF-së dhe i rekomandohet palës që të adresohet tek komisioni i ankesave.

Kalojmë te kërkesa tjetër nga kryetari i fshatit Lladroviq dhe shoqata e veteranëve UÇK-së të fshatit Lladroviq. Kanë kërkuar që parcela P-72316024-00311-2 me sipërfaqe 466m2 të përcaktohet si lokacion për kompleksin dhe vorrezat e veteranëve të UÇK-së të fshatit Lladroviq. Pjesa dërmuese e kësaj parcele është në pronësi të pronës shoqërore dhe kjo në vazhdim e sipër është shfrytëzuar për vorrezat e fshatit, mirëpo kjo sipërfaqe kërkojmë të na lejohet të specifikohet për veteranët e UÇK-së të fshatit Lladroviq.

Veton Zogaj: Duhet të ju dërgohet drejtorive të Gjeodezisë dhe Urbanizmit dhe ata e vlersojnë.

Hamit Lima: Nëse janë afër varrezave, atë munden me ba nën menaxhmin e Bashkësisë Islame.

Muharrem Morina: Dërgone në Gjeodezi.

Argjend Thaçi: Kërkesa e shoqatës së veteranëve të UÇK-së të fshatit Lladroviq rekomandohet për Gjeodezi dhe Urbanizëm.

Kërkesa e banorëve të lagjes Vrenezi Marali po e lëjmë për mbledhjen tjetër.P o konsultohemi me këtë palë dhe pastaj në mbledhjen tjetër e shqyrtojmë.

Kalojmë te kërkesa e Naser Ulluri, i cili kërkon ndihmë financiare për djalin e tij të sëmurë Nart Ulluri. Kjo sëmundje e djalit tim nuk ka shërim në Kosovë andaj më është rekomanduar një operim jashtë vendit, por kostja e operimit është shumë e lartë.

Sadik Vrenezi: Djali është në gjendje të keq. Një vizitë që e kanë bërë në Tiranë, djali ka mundësi deri në 80% me u përmirsu.

Veton Zogaj: Kërkesa prej kërkesës Kryesues dallon. Më mirë do ishte ose si KPF-w me ja ndarë si shumë ose të rekomandojm për te Kryetari, sepse në Kuvend po kemi ballafaqime se pse po sjellen disa kërkesa dhe disa jo. Unë mendoj që këti djalit si KPF-të ja ndajm 500E.

Gentianë Hoti: Te kjo kërkesa e Naserit mundemi me u arsyu për shkak të moshës.

Argjend Thaçi: Kush është për që kërkesa nga Naser Ulluri për djalin e sëmurë, të rekomandohet për Kuvend?

Unanimisht kjo kërkesë rekomandohet për kuvend.

Argjend Thaçi: Kërkesa e Syl Morina nga fshati Lubizhdë për përkrahje financiare sepse ballafaqet me sëmundje dhe me gjendje të rëndë ekonomike kërkoj që të më mbulohen disa shpenzime të operimit i cili më kushton rreth 2.000E. Kush është për që kërkesës së Syl Morina ti ndahen 250E?

Me vota unanime, kërkesës së parashtruar nga Syl Morina i ndahen 250E

Kërkesa e Miftar Krasniqit kërkon ndihmë financiare në shumën prej 3.500E për shërimin e gruas të sëmurë. Kush është për që kjo kërkesë të rekomandohet për Kuvend?

Me 4 vota për dhe 1 abstenim kjo kërkesë rekomandohet për Kuvend.

Kërkesa e Shemsie Morina është me probleme shëndetësore dhe me kushte të dobëta ekonomike. Kush është për që kësaj kërkesë ti ndahen 250E?

Me vota unanime, kërkesës së parashtruar nga Shemsie Morina i ndahen 250E.

Kërkesa e Qamile Elshanit thotë që është në gjendje të keqe shëndetësore dhe kushteve të dobëta ekonomike. Kush është për që kësaj kërkesë ti ndahen 250E?


Me vota unanime, kërkesës nga Qamile Elshani i ndahen 250E

Këtë mbledhje e shpalli të mbyllur. Faleminderit për prezencën!

Përfundoi në ora: 12:30.

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina



Kryesuesi i Kuvendit

Argjend Thaçi

